



BULETINI MUJOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE

(Pasqyra 14/Sh)

DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE

NENTOR, 2019

Buletini Mujor i Sëmundshmërisë Infektive publikohet çdo muaj nga Sektori i Survejancës dhe Shërbimi i Inteligjencës Epidemike, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP). Ky Buletin Mujor bazohet në të dhënat e Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës Mujore 14 Sh. Ai plotësohet në Pasqyrë në formatin EXCEL, dhe dërgohet me postë elektronike dhe me postë zyrtare, brenda datës 10 të çdo muaji, në Departamentin e Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive (DEKSI), Instituti i Shëndetit Publik. Të dhënat e agreguara të Pasqyrës 14 Sh për muajin nëntor 2019 janë të dhënat e raportuara nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) në rrethe.

1. Sëmundjet diarreike

Sëmundjet diarreike, gjatë muajit nëntor 2019 zënë 32 % të totalit të sëmundjeve infektive të raportuara me anë të Pasqyrës 14 Sh dhe paraqesin një incidencë 203.85 /100.000 banorë. Gastroenteritet e paspecifikuara janë të shpërndara në të gjitha rrethet e vendit, dhe zënë peshën kryesore në grupin e sëmundjeve diarreike. Ndërkohë që në nivel kombëtar, helmimet ushqimore paraqesin një incidencë (2.64/100.000 banorë). Rrethet Berat, Bulqizë, Lushnjë dhe Kukës mbajnë peshën kryesore në raportimin e helmimeve ushqimore. Duhet theksuar që, numri i lartë i rasteve të raportuara me helmime ushqimore dhe gastroenterite është i lidhur me pamundësinë në nivelin e disa rretheve të diagnozës së saktë klinike dhe konfirmimit të saj me diagnozën laboratorike mikrobiologjike.

Në muajin nëntor 2019 janë raportuar 5 raste të konfirmuara me Tifo abdominale, përkatësisht 2 nga rrethi i Tiranës, 2 nga rrethi i Lezhës dhe 1 rast nga Elbasani. Rastet janë konfirmuar në Institutin e Shëndetit Publik, dhe nga ana e NJVKSH-ve në rrethet përkatëse janë marrë të gjitha masat, si dhe është kryer hetimi në vatër. Dy raste i përkasin moshës 1-4 vjeç, 1 rast moshës 15-19 vjeç dhe 1 rast moshës 60-64 vjeç. Janë marrë kampione uji të pijshëm në vatër dhe në zonën përreth, të cilat kanë rezultuar brenda normave si nga ana fiziko-kimike dhe ajo mikrobiologjike. Koprokulturat e personave të kontaktit kanë rezultuar negativ.

Rrethi i Shkodrës mban peshën kryesore të incidencës së Salmonelozës jotifoide për muajin nëntor 2019 me 20 raste të konfirmuara, Tirana dhe Dibra përkatësisht me vetëm 1 rast me Salmonelozë jotifoide. Të gjitha rastet janë konfirmuar në laboratorin e rrethit përkatës.

Rrethi i Shkodrës mban peshën kryesore të incidencës së Shigelozës për muajin nëntor 2019 në nivel kombëtar, përkatësisht me 32 raste të konfirmuara, ndjekur nga rrethi i Krujës që ka raportuar 4 raste të dyshuara, të cilat për shkak të problemeve me laboratorin nuk janë konfirmuar.

Tabela 1: Frekuencat dhe incidencat e sëmundjeve diarreike për muajin nëntor 2019
(Incidenca raste/100.000 banorë)


	Raste, nëntor 2019	Incidenca nëntor 2019 (raste/100.000 banorë)
Tifo abdominale + Paratifo	5	0.18
Salmonelozë	22	0.79
Shigelozë (Disenteri bacilare)	36	1.29
Dizenteri amebike	0	0
Toksikoinfeksione alimentare	74	2.64
Gastroenterite (etiologji e panjohur)	5571	198.95
Sëmundje diarreike në total	5708	203.85

1. Sëmundjet e EPI

1.1. Fruthi

Gjatë muajit nëntor 2019 janë raportuar në total 4 raste të dyshuara me fruth, 2 raste nga Tirana dhe 2 nga Lushnja. Pas testimit laboratorik të 4 rastet rezultuan negativ për Fruth, dhe nëse e krahasojmë me të njëjtën periudhë të një viti më parë, në nëntor 2018 janë dyshuar në total 59 raste prej të cilave janë konfirmuar me IgM pozitiv 31 raste. Nga këto 53 raste i përkasin rrethit të Tiranës. Rastet pozitive i përkasin kryesisht grup-moshës < 1 vjeç (18 raste) dhe asaj 1-4 vjeç (17 raste). Kjo vazhdon të jetë grup-mosha më e prekur për shkak edhe të mosvaksinimit dhe kontaktit apo vizitës së mëparshme të tyre në Shërbimin Pediatrik në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë, (QSUT). Të gjitha rastet janë konfirmuar në Laboratorin e Virologjisë në ISHP.

Grafiku 1. Kurba epidemike e rasteve të dyshuara për fruth sipas datës së fillimit të rashit, nëntor 2018



1.2. Tuberkulozi pulmonar

Gjatë muajit nëntor 2019 nga rrethet janë raportuar 16 raste me Tuberkuloz (TB): 14 raste me TB pulmonar dhe 2 raste me TB ekstrapulmonar. Nga ekzaminimet laboratorike 12 raste janë konfirmuar sputum pozitiv. Rastet janë ritrajtuar ku njëri prej tyre ka rezultuar nga GeneXpert (rifampicine rezistent). Konfirmimi i tyre është kryer në Laboratorin e Referencës të rekomanduara nga Dispanseria e rrethit përkatës.

Vihet re se pacientët e konfirmuar me TB janë të gjithë të formave pulmonare dhe kanë rezultuar me sputum pozitiv, si dhe janë raportuar dy raste të ritrajuara edhe më parë. Për të gjitha rastet janë lajmëruar dispanseritë përkatëse për të komunikuar me familjarët e tyre, për të kryer kontrollin në vatër bazuar në të gjitha ekzaminimet për depistimin e tyre. Të gjithë pacientët kanë filluar mjekimin sipas skemës përkatëse.

2. Zoonozat

Gjatë muajit nëntor kemi patur tri raste të raportuara në të gjithë vendin, të konfirmuara me leptospirozë (0.11/100.000 banorë). Dy raste janë banorë të Fierit dhe 1 rast nga Lushnja. Rastet janë konfirmuar në laboratorin e ISHP-së. Nëse do ta krahasojmë me muajin paraardhës, vëmë re një rënie të numrit të rasteve për shkak të sezonalitetit të sëmundjes, pavarësisht shtrirjes gjithëvjetore të saj, por leptospiroza po paraqitet si një ndër

zoonozat më problematike në raport me zoonozat e tjera. Shkaku i shtimit të numrit të rasteve bazuar dhe në hetimete kryera, rezulton nga prania e shtuar e brejtësve (minjve), kontaminimi me urinën e infektuar si dhe ka ndikuar sezoni i përmytjeve dhe faktorë të tjerë lidhur me sëmundjen, veçanërisht në disa zona ku ka një numër të rritur të rasteve të raportuara.

Tabela 2: Frekuenca dhe incidencat e sëmundjeve Zoonotike në nëntor 2019 (Incidenca raste/100.000 banorë)

	Raste, nëntor 2019	Incidenca nëntor 2019 (raste/100.000 banorë)
Antraks (Plasje)	0	0
Brucelozë	1	0.04
Leptospirozë	3	0.11
Leishmaniaza viscerale	0	0
Leishmaniaza kutane	1	0.04

3. Hepatitet virale

Në raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit nëntor 2019 janë raportuar në total 31 raste me hepatite virale akute (Incidenca 1.11/100.000 banorë) nga të cilat, 3 raste janë hepatite virale të paspecifikuara, 1 rast hepatit viral akut A, 22 raste me hepatit viral B dhe 5 raste hepatit viral as A as B.

Në lidhje me hepatitin viral as A as B, 5 rastet e konfirmuara janë raportuar nga Lushnja dhe Tirana, ndërsa nga 22 rastet e raportuara me hepatit viral B 17 raste janë nga Tirana.

4. HIV/AIDS

Në muajin nëntor 2019 janë kryer në total 44 ekzaminime për HIV në Njësinë e Laboratorëve në ISHP, 20 meshkuj dhe 22 femra. Nga këto ekzaminime, 5 prej tyre kanë rezultuar pozitive (3 meshkuj dhe 2 femra). Rastet pozitive i përkasin moshave të ndryshme, përkatësisht nga 23 deri 36 vjeç. Rastet pozitive janë nga rrethet Tiranë, Koplik dhe Durrës. Mostrat e gjakut që kanë rezultuar pozitive, kanë ardhur në ISHP nga Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi” Tiranë, Spitali Infektiv, QSUT, Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut, Tiranë, IEPV “Ali Demi” dhe vullnetarë.

INSTITUTI I
SHËNDETIT PUBLIK

DEKSI